

BULETINI I IGJK-SË **Korrik – Gusht 2003**

Ky buletin botohet për të informuar më tërësisht gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës për aktivitetet e IGJK-së. Ky publikim i shpërndahet gjyqtarëve dhe prokurorëve kudo në Kosovë. Buletini mujor I IGJK-së tani paraqet artikuj nga stafi i IGJK-së në lidhje me çështjet me interes të gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë në Kosovë

Draftet Te Ligjeve Penale Dhe Te Miturit

Të mituri janë kategori e posaqme e kryesve të veprave penale.

Të gjitha ligjet penale të cilat aplikohen në Kosovë, përmbajnë dispozita të posaqme për kryesit të mitur të veprave penale.

Ligji penal i Jugosllavisë, mes tjerash, përmbanë dispozita për limitin e moshës të aplikimi i sanksioneve penale ndaj të miturve (mosdenueshmëria e fëmijëve), sanksionet e posaqme ndaj tyre, dispozitat mbi mundësinë e zhvillimit të procedurës penale dhe shqiptimit të sanksione varësisht prej moshës së ekzekutorit të mitur në kohën e gjykimit, aplikimin e masave edukuese ndaj personave të rritur të rinj. Dispozitat që kanë të bëjnë me masat edukuese, ndryshimin e vendimit mbi masën e shqiptuar, për pezullimin e saj dhe rivendosjen për masën edukuese, ekzekutimin e denimit të denimit me burg për të mitur dhe të tjerat, gjinden në Ligjin penal të Kosovës dhe në Ligjin penal të Sërbisë. Lidhur me procedurën penale ndaj kësaj kategorie të kryesve të veprave penale, Ligji mbi procedurën penale përmbanë shumë dispozita specifike të cilat gjinden në një kapitull të posaqëm. Kjo procedurë është në grupin të ashtuquajtur të procedurave të posaqme. Më në fund, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, në mes tjerash, përmbanë edhe dispozita për ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj të miturve.

Grupi i posaqëm punues ka punuar në përpilimin e ligjit të posaqem për të miturit i cili kishte për të përmbajtur të gjitha dispozitat të përmendura. Andaj, së pari, ky ligj kishte me qen nje kodifikacion sepse kishte për të përmbajtur në një vend të gjitha dispozitat penale për të miturit, dhe në anën tjetër, kishte për të përmbajtur edhe disa dispozita të reja ose të modifikuara me qëllim të modernizimit të ligjit.

Nga ana tjetër, opinioni është i njoftuar se janë përpiluar draftet të Ligjit të përkohshëm penal të Kosovës dhe Ligjit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës. I pari përmbanë dispozitat të cilat më parë kanë qenë në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaqme të Ligjit penal të Jugosllavisë, të cilat tani janë edhe të ndryshuara dhe përmbajnë edhe plotësime, si dhe dispozitat më parë të përmbajtura në Ligjin penal të Kosovës dhe në Ligjin penal të Sërbisë. Ligji i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës, në draftin e përpiluar, në shkallë të lartë dallon nga Ligji i procedurës penale i cili tani është në aplikim, posaqërisht në pjesën e cila ka të bëjë me kompetencat e policisë, të prokurorit publik dhe të gjyqtarit hetues. Ajo që është me rëndësi shumë të madhe është se draftet të cekura nuk përmbajnë dispozita për të miturit. Këto dispozita janë të ndara dhe të futura në draftin e Ligjit për të miturit.



Hyrja paralele në fuqi të drafteve të cekura është shumë e rëndësishme. Nëse Ligji i përkohshëm penal i Kosovës dhe Ligji i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës nënshkruhen dhe hyjnë në fuqi ndërkaq e njëjta nuk ndodh edhe me Ligjin për të miturit, do të jemi në situatë që nuk do të ekzistojnë dispozitat penalojuridike për procedurën ndaj të miturve dhe ndaj kryesve të mitur të veprave penale nuk do të ketë mundësi të zhvillohet procedura penale. Kjo për arsye se me Ligjin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës do të çfuqizohet ligji i mëparshëm dhe dispozitat për të miturit nuk do të ekzistojnë.

Me qëllim të shpjegimit më të pollësishëm, do të precizojë disa pjesë të dispozitave kalimtare dhe përfundimtare të të dy drafteve.

Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të draftit të Ligjit të përkohshëm penal të Kosovës (neni 354.) thuhet se dispozitat të legjislacionit penal të zbatueshëm ndaj kryesve të mitur të veprave penale, për personat të paaftë mentalisht ose për ata me aftësi të kufizuara, ndaj krzesve të varur nga droga dhe alkooli do të vazhdojnë të zbatohen edhe pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi, derisa të nxjerren ligje të posaqme për këtë kategori të personave. Me tutje në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të të

nëjtit ligj, në nenin 359. thuhet se ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, pushon zbatimi i dispozitave të **Ligjit penal, me të cilat janë rregulluar çështjet në këtë Kod**, nëse shprehimisht nuk është paraparë ndryshe me këtë Kod (nenet 342,343,344,345).

Përfundimi është se këto dispozita kanë të bëjnë me **ligjin material**. Andaj, është e kuart se dispozitat të ligjeve “të vjetra” materiale do të aplikohen deri në momentin kurr ligji i ri në këtë fushë do të nxjerret.

Situata nuk është e njëjt me ligjin procedural. Në dispozitat kalimtare dhe të fundit të Ligjit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës një dispozitë e kështill nuk ekziston. Më saktësisht, në nenin 554. të dispozitave kalimtare dhe të fundit thuhet decidivisht si vijon **“me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, dispozitat e ligjit në fuqi të cilat rregullonin çështjet nga ky Kod pushojnë të zbatohen, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.”** Qëndron fakti se fusha e të miturve nuk është paraparë ndryshe por është hjekur dhe , sipas kuptimit tim këtu ekziston vakumi i cili do të ekzistojë deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit për të miturit.

Nesrin Lushta
Instituti gjyqësor i Kosoves
16 qershor 2003



Pavorsia E Gjyqtarëve Dhe Prokurorëve Në Kosovë

Një Temë E Rëndësishme – Jo Vetëm Në IGJK

E prezentuar nga Dr. Horst Proetel

Alinea 9.4.4 e Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 në lidhje me “Kornizën kushtetuese për vetëqeverisjen provizionale në Kosovë thekson në mënyrë demonstruese:

Gjyqtarët do të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

Çfarë don të thotë kjo dhe si do të realizohet dhe jipet kjo është një nga pyetjet e vështira të cilat janë të diskutuara në seminar të IGJK-së mbi temën “Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.” Ky seminar i ofrohet në mënyrë përsëritëse të gjithë kolegëve në vend dhe mundohet të ballafaqohet me çështjet fundamentale të pozitës sonë profesionale dhe të drejtave dhe detyrave korresponduese.

Çfarë don të thotë pavorsia dhe paanësia është gjithashtu një nga pyetjet të cilat kandidatët të cilët aplikojnë për pozitat e zbrazëta të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet t’i përgjigjen në intervistat e Këshillit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës (KGJPK). Përshtypja ime si anëtar i këtij këshilli është se aty ka ca paqartësi dhe konfuzion, sidomos në definimin e të dy termeve dhe pasojat praktike.

Pavorsia nga kush dhe çka

Sistemi gjyqësor si tërësi ka nevojë të organizohet në mënyrë të veçantë dhe duhet të sigurohet nga qeveria për të përmbushur detyrat të cilat i janë dhënë për detyrë që të kryhen. Por pavorsia është një atribut, nga a cila secili gjyqtar personalisht profiton, madje kjo nuk është ndonjë privilegj. Ai ose

ajo është organi veprues i cili duhet të realizoj drejtësinë.

Gjyqtari është i pavarur në veprimin e tij/saj profesional dhe në lidhje vendimet të cilat ai/ajo duhet ti jap. Kjo quhet “pavorsia në rem”. Në lidhje me këtë ai/ajo nuk është totalisht i pavarur nga fuqia e parë e shtetit, legjisllacionit. Në të kundërtën ai/ajo duhet të aplikojnë ligjin në mënyrë të sakt, duke zbuluar nëse has në rastin konkret dhe si do të interpretohet ai. Ai/ajo duhet të punoj në mënyrë të sakt, me profesionalizëm dhe “karakter më të lartë moral” (9.4.7 e Kornizës kushtetuese). Pavorsia e një gjyqtari andaj mund të jipet vetëm në lidhje me fuqinë e dytë të shtetit, ekzekutivit, fuqisë qeveritare. Këtu qëndron duke pritur rreziku i vërtetë për pavorsinë, madje edhe në demokracitë e vjetra të sunduara nga ligji. Dyrët më tipike për ndikim në fuqinë ekzekutive është mënyra e rekrutimit, vlerësimet dhe përparimet e gjyqtarëve, caktimi i detyrave, autoriteti mbikqyrës dhe sanksionet disiplinore. Organi i shkeljes së mundshme të pavorsisë shumë shpesh do të jetë kryetarit i gjykatës, i cili zakonisht është përfaqësues i fuqisë ekzekutive në gjykatë dhe në qarkun e tij/saj.

Masat për përforcimin e pavorsisë së gjyqtarëve

Në sistemet e zhvilluara gjyqësore çdo gjë bëhet për t’përforcuar transferet e vetëqeverisjes gjyqësore të fuqisë disiplinore në gjykatat e pavarura, të cilat gjithashtu e kanë detyrë të tregojnë, nëse pavorsia e gjykatës është ngacmuar.



Gjyqtarët dhe prokurorët nga shoqatat të cilat janë vështues kritik të gjyqësisë dhe ofrojnë asistencë në mbrojtjen e pavarësisë së kolegëve. Zhvillimi i gjyqtarit stabil dhe guximtar – nevojitet personaliteti. Mesiguri që kjo kërkon kohë dhe do të arrihet vetëm kur gjyqtarët të jenë mirë të rrespektuar sidomos nga qeveria, duke u përmbajtur nga marrja e ndikimit të veprimeve dhe vendimeve gjyqësore. Nuk vëhet në dyshim ajo se ne na nevojitet një autoritet mbikqyrës, pasi që pretendimi i qytetarëve për të gjetur qasje në gjykatë duhet rrespektuar dhe **“një shqyrtim i drejtë dhe publik brenda një kohe të arësyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar nga ligji”** (Neni 6 i Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut) duhet të ofrohet.

Ajo që vetëdija e aplikantëve për një pozitë të gjyqtarit në lidhje me pavarësinë e gjyqtarit nganjëherë është e pamjaftueshme mund të dëshmohej me një shembull. Pasi që janë pyetur nëse kanë ndonjë brengë nëse kryetari i gjykatës lëshon një urdhër për të standardizuar jurisdiksionin në gjykatën e tij, duke thirrur për interpretim special të një dispozite të paqartë, kjo pyetje është mohuar. Duket se disa kandidatë nuk janë të vetëdijshëm për problematikën e adresuar.

Pavarsia në kuptimin personal

Një parakusht thelbësor për pavarësinë e gjyqtarëve është se ata kanë kushte të arësyeshme për punë dhe jetesë. Ata duhet të caktohen së paku për një periudhë të gjatë, të caktuar, duke përjashtuar fuqinë e qeverisë për t'i lëvizur ata – përveç kësaj ligji lejon ndryshimet e tilla – dhe për t'i larguar ata nga zyra e tyre – përveç kësaj

zbatohet një gjykim disiplinorë. Situata aktuale gjyqësore është e mjaftueshme edhe pse aty ka disa brenga në lidhje me mungesën e mjeteve ndaj largimit nga zyra, e vendosur nga PSSGJ në përputhje me një vendim të KGJPK.

Më tepër problematike është rroga e ulët e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Madje ne duhet të marrim parasysh kushtet e përgjithshme të pamjaftueshme, sidomos shkallën e lartë të papunësisë dhe pagat e ulta në përgjithësi, rroga e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor nuk korrespondon me detyrat e përgjegjësive dhe sfidueset të gjyqësisë në zhvillim të bazuar në sundimin e ligjit. Supozohet të jetë më e ulta ose afër më të ultës në Ballkan, duke i bërë këto profesione ekonomikisht joatraktive. Gjyqësia supozohet të ketë mangut personat më të kualifikuar dhe është e rrezikuar për të humbur kolegët e tillë në avokaturë dhe profesionet tjera të suksesshme. Një pagë e përshtatshme ndihmon në preventimin e korrupsionit. Dhe më së shumti shpreh vlerën dhe rrespektin të cilin shoqëria i a dhuron sistemit ligjor, fuqia e tretë. Kjo duhet të forcohet për të zgjidhur problemet më dominuese në këtë rajon.

Paanshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, duke i'u referuar Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/8, përshkruan në veçanti përgjegjësitë e një gjyqtari **“të veprohet në mënyrë të paanshme ... në të gjitha rastet dhe shpër nga ndikimi i jashtëm, dhe të zbatohen detyrat gjyqësore bazuar në faktet dhe ligjin e aplikueshëm në secilin rast, pa ndonjë restriksion, ndikim të pahijshëm, shtytje,**



presion, kërcënime ose ndërhyrje, direkte apo indirekte, nga cilido drejtim.”

Detyrat e ngajshme janë të emëruara në Kodin e etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve.

Përderisa pavarësia don të thotë gjyqësia e cila vepron pa ndërhyrje nga qeveria, paanshmëria është plotësimi i detyrave pa përmendur ndikimin e personave të interesuar dhe grupeve trysëse, vendimi pa ndonjë motiv irelevant dhe interesat jolegjitime.

Në lidhje me këtë ne duhet të kuptojmë se praktika dhe të priturat e shoqërisë në vendimet e gjyqtarëve dhe autoriteteve tjera mund të jenë të ndryshme në rajon. Në cilindo rast gjyqtarët dhe prokurorët duhen të trajnohen në internalizimin e këtyre virtuteve dhe parakushteve gjyqësi

funksionuese dhe të pranuar të sunduar nga ligji, i cili do të fitoj besim. Ne duhet të inkurajojmë kolegët tonë që të zbatojnë praksën, ashtu siç kërkon Kodi i etikës, “ **në të gjitha kohërat dhe në një mënyrë e cila promovon konfidencën publike në dinjitetin, integritetin dhe pavarësinë e gjyqësisë.”**

Ne të gjithë mund të ndihmojmë të zbusim kushtet e punës ashtu siç u përmend. Një nga masat e përshtatshme është gjithashtu të bëhet mbrojtja më e mirë e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor, të cilët janë të obliguara ta bëjnë veten jo të popullarizuar.

--- Dr. iur. Horst Proetel ka qenë gjyqtar kryesor në Gjykatën e Lartë të Qarkut – Gjykatën Supreme në Thuringia/Gjermani në Jena dhe vepron që një vit si Zyrtarë Trajnimi Gjyqësor në Institutin Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë. Ai është anëtar i KGJPK -

Projekt Aktivitetet Për Korrik-Gusht 2003

- Trajnim i shkathtësive profesionale
- Seminar nga e Drejta civile
- Seminar për gjyqtarët për kundërvajtje
- Vizitat studimore jashtë vendit

Trajnim I Shkathtësive Profesionale

30 Qershor – 02 Korrik, dhe 16 – 18, 21 – 23 Korrik, 2003

IGJK, në ndërlidhje me Organizatën Ndërkombëtare Ligjore për Zhvillim (ONLZH), e financuar nga USAID, ka organizuar një seri të Kurseve trajnuese të shkathtësive profesionale të quajtura “Nga caktimi i rastit deri te vendimi përfundimtarë: Ndërtimi i shkathtësive efektive vendim-marrëse.” Kjo seri e trajnimeve do të përqendrohet në zhvillimin e shkathtësive esenciale të nevojshme në punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo është faza e dytë e programit të përgjithshëm. Temat e mbuluara në këtë fazë janë kështu si vijon:

- Temat e mbuluara në ditën e parë të trajnimit përfshijnë rëndësinë e shkathtësive praktike, marrëdhënjen në mes kualitetit të një vendimi dhe vonesave të gjykatës, ekzekutimi i aktvendimeve, të drejtat njerëzore, pregatitja e procesit të vendim-marrjes, një prezentim mbi “Shkathtësitë e draftimit dhe prezentimit”, legjisllacioni mbi përmbajtjen e aktgjykimeve, aktpaditë dhe vendimet e tjera.



- Dita e dytë vazhdon me ushtrime mbi formulimin e çështjeve dhe draftimit, një diskutim mbi rezultatet e ushtrimeve dhe një prezentim mbi "Hulumtimin e vendim-marrjes".
- Dita e tretë përmbyll trajnimin me ushtrime lidhur me një analizë të vendimeve gjyqësore, një prezentim mbi "Transparencën e vendimeve gjyqësore", një hulumtim të çështjeve lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve, me një fokus të veçantë mbi atë se si të përmirësohet bashkëpunimi në mes palëve përgjegjëse në procesin e ekzekutimit.

Nga 30 Qershori – 02 Korriku, sesioni do të ofrohet për Gjyqtarë penalist dhe prokurorë publik. Pastaj nga 16 – 18 dhe 21 – 23 Korriku sesionet do të mbahen për Gjyqtarë civilist. Ftesat janë dërguar për t'i njoftuar pjesëmarrësit se për cilin sesion ata janë caktuar që të marrin pjesë. Të gjithë gjyqtarët e Kosovës do të ftohen për fazën e dytë të trajnimit, ashtu siç kanë qenë për fazën e parë.

Seminar Nga E Drejta Civile – Posedimi Dhe Pengim-Posedimi

03 Korrik 2003

Një seminar nga e drejta civile do të mbahet me 03 Korrik, 2003. Temat të cilat janë caktuar për t'u mbuluar janë posedimi dhe pengim-posedimi. Gjyqtarët civilist nga anembanë Kosova janë ftuar për të marrë pjesë në këtë ngjarje.

Seminar Gjyqtarët Për Kundërvajtje

09 Korrik 2003

Një seminar për Gjyqtarët për kundërvajtje është caktuar për 9 Korrik. Temat e planifikuara janë Parimet dhe institucionet e procedurës kundërvajtëse, Fillimi dhe rrjedha e procedurës kundërvajtëse dhe procedura speciale për të mitur. Ky trajnim është caktuar për secilin kuartal të vitit. Secilën herë, grupe të ndryshme të Gjyqtarëve për kundërvajtje janë ftuar, në mënyrë që të trajnëhen të gjithë përgjatë tërë vitit. Dy gjyqtarë nga Gjykata e lartë për kundërvajtje janë caktuar për të japur leksione..

Ngjarjet Tjera

Vizitat Studimore Jashtë Vendit

IGJK është duke vazhduar përgatitjet për vizitën e ardhshme studimore të ofruar në programin tonë vjetor, në Zvicërr. Kjo vizitë studimore do të zë vend nga 23 – 29 Gushti. IGJK planifikon të dërgojë (10) magjistratë dhe një trainues gjyqësor në këtë trajnim. Aplikacionet janë pranuar dhe përzgjedhja përfundimtare do të bëhet në Qershor. Përgatitja për vizitën studimore në Bullgari është gjithashtu në vazhdim e sipër. Gjithashtu, hapat preliminarë janë duke u bërë në mënyrë për t'u përgatitur për vizitë studimore në Gjermani, të cilën tentojmë t'a mbajmë me 09-15 Nëntor. Këto dy ngjarje do të marrin pjesë në kuartalin e tretë dhe të katërt të vitit 2003.

